



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Deliverty		07 - 06	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIMSHICK	2918/2021		1/4		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.257/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.257/2021 të datës 08.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Zejnel Elshani", Nr.8, Objekti Nr.1, Hyrja Nr.1, Kati 4, Nr.21, në Komunën e Prishtinës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.257/2021 e datës 08.04.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHET Vendimi nr.65/2021 i datës 31.03.2021 i zv.Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ta kthejë ankuesin në vendin e punës "Zyrtar Ligjor" në Departamentin Ligjor, si nëpunës i karrierës pa afat, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë sipas Akt emërimit të datës 01.08.2018.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj Ankuesit i punësuar në Ministrinë e Financave sipas Akt emërimit të datës 01.08.2018 në pozitën e punës „Zyrtar Ligjor“, në Departamentin Ligjor, me datë

31.03.2021 Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nxjerr Vendim me numër 65/2021, me të cilin ankuesin e transferon përkohësisht për nevoja të institucionit në pozitën e punës "Përkthyes Shqip-Serbisht dhe anasjelltas", në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Financave.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 65/2021, të datës 31.03.2021, të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me datë 08.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1667/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.04.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Financave, ndërsa me datë 21.04.2021 Ministria e Financave ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1667/2021 të datës 08.04.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.65/2021, i datës 31.03.2021, i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave; Akt emërimi i ankuesit i datës 01.08.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i ankuesit i datës 29.03.2018; Diploma e ankuesit Nr.1288, e datës 15.05.2006; Konkursi i Ministrisë së Financave për pozitën Zyrtar i Lartë për Përkthime; Kërkesa për përgjigje e datës 14.04.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 21.04.2021; Kërkesa për punësim e ankuesit e datës 03.05.2018; Certifikata e datës 05.12.2017; Letër reference e datës 18.08.2000; Shkresa reference e datës 25.04.2012; Letër reference e datës 13.02.2001; Diploma e datës 18.04.2010; Letër reference e datës 25.02.2004; Përshkrimi i detyrave të punës për titujt e vendeve të punës në nivelin qendror dhe lokal, të plotësuara dhe përmirësuara Qershor 2016; CV e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit

është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se *zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve* Vendimin me numër 65/2021 të datës 31.03.2021, për transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita e Zyrtarit Ligjor në Departamentin Ligjor në pozitën "Përkthyes Shqip Serbisht dhe anasjelltas" në Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve e ka nxjerr në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: "1. *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori*" si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili përcakton se, 8. *Përshkrimi i përgjithshëm i punës për kategorinë Profesionale 1. Kategoria Profesionale është kategoria përgjegjëse për zbatimin e detyrave në përputhje me dispozitat ligjore, udhëzimet dhe procedurat e cila ofron mbështetje profesionale dhe administrative, pa u përfshirë në përgjegjësi mbikëqyrëse. 2. Veprimtaria e përditshme kërkon njohuri të përgjithshme profesionale dhe administrative dhe/ose njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar", sepse edhe përkundër faktit që në pajtim me dispozitën e nenit 52 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë ku thuhet se mënyrë të përgjithësuar se „Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë*

tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori', udhëheqësi me i larët administrativ është i obliguar që në zbatimin e kësaj dispozite të marr parasysh të gjitha specifikat e pozitës së lirë dhe plotësimin e kushteve ligjore të nëpunësit që transferohet respektivisht ne rastin konkret me rastin e transferimit të ankuesit zv. Sekretari i Përgjithshëm ka qene i obliguar që të merr parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e ankuesit në raport me përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesat specifike të vendit të punës ku eshte transferuar nëpunësi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit i cili pretendon se nuk i plotëson kriteret, pasi që nuk ka Licencë dhe Certificate valide për përkthim Shqip-Serbisht dhe anasjelltas, si dhe pas analizimit me kujdes të dëshmive të ofruara nga palët, ka konstatuar se pretendimi i ankuesit është i qëndrueshëm sepse në baze të dëshmive të ofruara gjegjësisht Kopjes së konkursit të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të datës 02.03.2021 për pozitën "Zyrtar i lartë për përkthime" janë përcaktuar këto kushte: „*Kualifikime të posaçme formale: • Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës si dhe Kualifikime të posaçme formale ;Licenca/certifikata valide për përkthim në gjuhë shqipe - Serbe dhe anasjelltas, e po ashtu ne konkurs është përcaktuar se kandidatët duhet të dorëzojnë Kopje të Licencës / Certifikatës valide për përkthim në gjuhë Shqip-Serbe dhe anasjelltas, ndërsa ne rastin konkret ankuesi është i emëruar sipas Akt emërimit të datës 01.08.2018 në pozitën Zyrtar Ligjor në Departamentin Ligjor, si nëpunës i karrierës pa afat, dhe me koeficient 7, pas përfundimit me sukses të procedurës se rekrutimit të shpallur në konkursin publik të datës 21.04.2018 dhe në kërkesën për punësim të ankuesit të datës 03.05.2018, të sjellur si dëshmi nga organi i punësimit, ankuesi ka deklaruar se prej muajit 02/2000 deri më 09/2000 ka punuar si përkthyes në Kinder Berg International dhe në Relief International – USA, po ashtu edhe në pjesën e aplikacionit për njohjen e gjuhëve të huaja ka deklaruar se gjuhën serbe e njeh mirë, dhe se në dokumentet që ia ka bashkangjitur aplikacionit të lartcekur ka edhe Diplomën Nr.1545 të datës 18.04.2010, të lëshuar nga Qendra Edukative Multididaktike në Prizren, me të cilën vërtetohet se ankuesi e ka përfunduar kursin e gjuhës serbe, por rrjedhimisht nga kjo që u tha më lartë, Kolegji konstaton se pretendim i ankuesit është i bazuar sepse kemi të bëjmë me një pozitë profesionale për të cilën kërkohen kualifikime dhe licenca të posaçme e të cilat ankuesi nuk i posedon dhe si rrjedhojë edhe përkundër vullnetit dhe dëshirës për të ndihmuar në mbulimin e pozitës së lirë, ankuesi si zyrtar ligjor nuk ka të drejtë ligjore që ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë e një pozite për të cilën nuk ka kualifikim dhe përgatitje adekuate siç kërkohet me ligj respektivisht nuk posedon Licencë për përkthim Shqip-Serbisht dhe anasjelltas.*

Duke marr parasysh të gjitha këto, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se zyrtari kryesor administrativ me rastin e vendosjes për transferimin e nëpunësit civil duhet në mënyrë obligative të marr parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e nëpunësit në raport me përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesat specifike të vendit të punës ku duhet të transferohet nëpunësi civil.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave e ka miratuar si të bazuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me shkeljet e bëra pasi që zyrtari është transferuar në një pozitë që nuk është pozitë e të njëjtës kategori.

Zyrtari kryesor administrativ apo zyrtari përgjegjës që vendos për transferimin e nëpunësit civil, me rastin e transferimit duhet të marr parasysh dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 26/2020 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, e në rastin konkret të transferimit të ankuesit është dashur të merret parasysh dispozita e kësaj rregulloreje që përcakton se në kuadër të kategorisë profesionale janë të përfshira këto katër nën kategori: Profesional 1 1. Zyrtar i lartë; Profesional 2 2. Zyrtar i mesëm; Profesional 3 3. Zyrtar Profesional 4 4. Zyrtar Administrativ.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.257/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

